



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 439 Prot.

Tiranë, më 06. 03. 2025

V E N D I M

Nr. 53, Datë 06 . 03 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 172 Regj., datë 23.08.2024, paraqitur nga z. H.M kundër Shoqërisë “ERVISI” sh.p.k, me Nipt xxxxxxxxxx, përfaqësuar nga Administratori z. E.J , në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të *aftësisë së kufizuar*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pala ankuese parashtroi:

“Unë H.M së bashku me shoqëruesen time dhe një anëtar të Shoqatës Shpresë për të verbrit, shoku A.M, do udhëtonim në datën 10.08.2024 nga Cërriku për në qytetin e Gramshit dhe hipëm tek kryqëzimi i Cërrikut në autobusin me targa AA 112 RU. Autobusi nuk kishte fatorino.

Hipim në orën 08:00 dhe arrijmë rreth orës 09:00. Kur zbritën shoferit i cili mblidhte lekët e biletës, i paraqitëm librezën dhe i thamë që duhet të udhëtonim me gjysmë bilete. Shoferi na tha nuk e njoh librezën dhe as ligjin dhe nuk keni për të hipur më në autobusin tim për Gramsh.”

Përfundimisht pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe eliminimin e pasojave që vijnë për shkak të tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës u konstatua se, pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Berat-Gramsh, me të cilën kishin udhëtuar në datën 10.08.2024, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuese.

Në këto kushte, Komisioneri, me shkresën nr. 1186/1 prot, datë 06.09.2024, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim.

Me shkresën nr.17191/1 prot, datë 12.09.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), përcolli informacionin duke sqaruar ndër të tjera se: *“Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, në zbatim të Urdhrit Nr.318, datë 02.11.2020 “Për delegim kompetence”, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, është organ kompetent për nënshkrimin e licencave dhe certifikatave në transportin ndërqytetës të udhëtarëve me autobus dhe nuk ka kompetenca kontrolli në terren për shpërndarjen e biletave në transportin ndërqytetës. Linja e rregullt e transportit të udhëtarëve Berat-Gramsh-Berat është e miratuar me Udhëzimin Nr.5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse”, i ndryshuar, dhe lëshimi i licencës/certifikatave për operimin në këtë linjë kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, ndërsa linja Gramsh-Berat-Gramsh nuk është pjesë e rrjetit të linjave të miratuara ndërqytetëse. Nga verifikimi në sistemin elektronik e-Transport, rezulton se një linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Berat-Gramsh-Berat, është licencuar shoqëria “Ervisi” shpk, me NIPT, mbajtës i licencës me nr.171, lëshuar në datë 15.08.2022, me afat vlefshmërie deri në datë 14.08.2027.....Lidhur me kërkesën tuaj për informacion për mjetin me targë AA 112 RU, rezulton në pronësi të subjektit Ervisi sh.p.k dhe është i pajisur me certifikatë operimi nr.3, lëshuar në datë 14.08.2023, me afat vlefshmërie deri në datë 14.08.2024 në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës të udhëtarëve Berat-Gramsh-Berat, aktualisht është në fazë rinovimi certifikate.....”*

Në kuadër të procedurës së shqyrtimit paraprak të ankesës, me shkresën nr. 1186/3 prot, datë 19.09.2024, Komisioneri kërkoi nga z. H.M dhe z. A.M, plotësimin e ankesës me informacionin e nevojshëm.

Më datë 25.09.2024, z. H.M plotësoi ankesën me informacionin e kërkuar nga Komisioneri, i cili u administrua pranë Komisionerit me nr. 1186/4 prot datë 25.09.2024.

Me shkresën nr. 1186/5 prot, datë 07.10.2024, Komisioneri ju drejtua sërish z. A. M me kërkesën për plotësimin e ankesës me informacionin e kërkuar. Z. M. nuk iu përgjigj kërkesës së Komisionerit dhe nuk e plotësoi ankesën me informacionin e kërkuar.

Sa më sipër dhe në bazë të nenit 33, pika 4, germa “ç”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ku përcaktohet: “ 4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”, Komisioneri çmoi se procedura e shqyrtimit të ankesës për z. A.M nuk mund të vazhonte, pasi nuk plotësoi ankesën me informacionin e kërkuar.

Në këto kushte, Komisioneri vijoi me procedurat e shqyrtimit të ankesës i vetëm për z. H.M .

Pasi ankesa u vlerësua se ishte në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 33, pikat 3 dhe 4, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj, duke ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

1. Me shkresën me nr. 1186/6 prot., datë 22.10.2024, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria ERVISI sh.p.k, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.
2. Shoqëria ERVISI sh.p.k ka kthyer përgjigje, e cila është administruar pranë Komisionerit me nr. 1186/8 prot, datë 07.11.2024. Në parashtrimet e sjella, subjekti parashtron:

“Unë Ervis Javo në cilësinë e administratorit të shoqërisë ERVISI sh.p.k, me NIPT xxxxxxxxx, mbajtës i licencës me nr. 171, lëshuar në datë 15.08.2022, me afat vlefshmërie deri më datë 14.08.2027, për linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Berat – Gramsh-Berat parashtroj informacionin si më poshtë:

Mjeti me targë AA 112 RU është në pronësi të shoqërisë ERVISI sh.p.k dhe është i pajisur me certifikatë operimi nr.3, lëshuar më datë 14.08.2023, me afat vlefshmërie deri më datë 14.08.2024 në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës të udhëtarëve Berat-Gramsh-Berat, aktualisht është rinovuar.

Shoqëria ERVISI sh.p.k ka 22 vite që operon në linjën ndërqytetëse dhe ofron shërbimin e transportit për personat me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në udhëzimin e Ministrit të Transportit nr. 5627, datë 18.11.2016.

Ankesën e shtetasit H.M e analizoj me ndjenjë të lartë përgjegjësie, duke u nisur dhe nga fakti që bëhet fjalë për një person me statusin e të verbërit. Nga ana ime si administrator i shoqërisë i është bërë e qartë të gjithë drejtuesve të autobusëve se personat me librezë që përfitojnë statusin e invalidit, të verbërit etj, jemi të detyruar të zbatojmë ligjin ku ata udhëtojnë me ½ e biletës.

Në datë 10.08.2024 ka qenë në autobus shoferi zëvendësues, i cili nuk ka pasur dijeni për ligjin e sipërpërmendur, të cilit i kam tërhequr vëmendjen për rastin në fjalë.

Për sa i përket biletës, nuk i është ofruar qytetarëve pasi ka më shumë se një vit e gjysmë që nuk na janë vënë në dispozicion nga Ministria e Financave.

Për sa i përket dokumentit të paraqitur nga ankuesi, ju bëj me dije se shoferi nuk e mbante mend një detaj të tillë.

Nga ana e shoqërisë nuk do të ketë asnjë rast diskriminimi për personat me statusin e të verbërit të cilët paraqesin dokumentacionin origjinal të statusit të verbërit. Përgjatë viteve të punës shoqëria nuk ka pasur asnjë rast ankese, pasi nga ana jonë nuk u është kërkuar asnjëherë pagesë personave me status të veçantë. Ne do të vazhdojmë të kërkojmë me këmbëngulje nga të gjithë drejtuesit e automjeteve (autobusëve) që të zbatojnë me korrektësi dhe vullnet të plotë kërkesat e ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.”

3. Nëpërmjet shkresës nr.1186/9 prot, datë 08.11.2024, ankuesit i është komunikuar përgjigja e subjektit. Në vijim të këtij komunikimi, ankuesi nuk depozitoi parashtime shtesë.
4. Bazuar në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “ 8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore publike në datën 20.01.2025. Në këtë seancë morën pjesë të dy palët e përfshira në procedurë, ankuesi H.M dhe Shoqëria “ERVISI” sh.p.k, përfaqësuar nga z.E.J , Administrator.
5. Në datën 26.02.2025¹, ankuesi ka paraqitur para Komisionerit kërkesën për tërheqjen nga ankesa, pasi konsideron se ajo mori zgjidhje. Nëpërmjet kësaj kërkeje, ankuesi parashtron se, pas ballafaqimit në seancë dëgjimore, kishte arritur në një marrëveshje me subjektin. Në këto kushte ai e konsideron të zgjidhur problematikën për të cilën ka paraqitur ankesën pranë Komisionerit dhe të drejtën e tij si person me aftësi të kufizuara në lidhje me këtë linjë të transportit, si të përmbushur.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

¹ Administruar me nr.369 prot., datë 26.02.2025.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 172 Regj., datë 23.08.2024, të paraqitur nga z. H.M , pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Aftësia e kufizuar:
Fusha: Të mira e shërbime/Transport
Lloji i vendimit: Arritje efektiviteti